



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT MJEDISOR

Nr. 7413 Prot.

Tiranë, më 14.09. 2018

Nr. Identifikimi 672

Vendimi 42

DEKLARATË MJEDISORE

Në mbështetje të Ligjit Nr. 12/2015 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 10440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", VKM Nr. 686, datë 29.7.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiave e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" dhe me propozim të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Ministri

VENDOSI:

Lëshimin e Deklaratës Mjedisore për **Zhvilluesin** me të dhënat si më poshtë:

Emri i Subjektit: "Bashkia Polican"
Nr. NIPT-i: K49312401S
Adresa e selisë: Bashkia Polican, Skrapar
Personi përgjegjës: Adriatik Zotkaj

Për të zhvilluar projektin: "**Shfrytëzim i mineraleve ndërtimore me karrierë**"

Aplikimi është bërë referuar Ligjit Nr. 10440, datë 7.7.2011 "Për Verësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojça I, "Projektet që i nënshtrohen Proçedurës së Thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis"; Pika 19. Gurore dhe miniera sipërfaqësore, ku sipërfaqja e vendit është mbi 0,5 hektarë, ose vende për nxjerrjen e torfës, ku sipërfaqja e vendit është mbi 1 hektar.

Vendndodhja: Objekti mineral "Paraspuar", zona nr. 426/1, Polican, Skrapar, Berat
Sipërfaqja totale: 0.035 km²
Lloji Mineralit: Gur gëlqeror pllakor

(Bashkangjitur vendimit, gjeni aneksin me hartën topografike dhe koordinatat metrike, ku tregohet vendodhja e objektit)

Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", i ndryshuar, i sugjerohet autoritetit planifikues:

Miratimi i lejes/licencës së zhvillimit të atij projekti, me kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi, për të parandaluar, minimizuar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis;

Bazuar në pikën 2, të nenit 12, të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis", të ndryshuar, më poshtë po listojmë:

1. Qëndrimin e Ministrisë dhe sipas rastit, kushtet që duhet të përmbushen nga zhvilluesi:

Drejtoritë Teknike të Ministrisë shprehen:

Rekomandojmë mbajtjen parasysh të referencave ndaj ligjit të pyjeve dhe të dhënave kadastrale për pyjet dhe kullotat.

2. Informacion për procesin e realizuar të konsultimit me publikun:

Konsultimi me publikun: Morën pjesë përfaqësues nga komuniteti i zonës, përfaqësues nga Pushteti Vendor si dhe nga Drejtoria Rajonale e Mjedisit dhe përfaqësues nga studio mjedisore. Nuk pati ndonjë shqetësim nga komuniteti për zhvillimin e këtij aktiviteti. Në takim është prezantuar projekti, janë dëgjuar sugjerimet e pjesëmarrësve, të cilat do të merren parasysh nga ana e investitorëve, gjatë kohës së shfrytëzimit. Nga ana e investitoreve iu sigurova të pranishmeve që do të merren të gjitha masat për eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, duke mos cënuar jetën e banorëve.

3. Arsyet dhe konsideratat kryesore, ku është mbështetur mendimi;

Zhvillimi i aktivitetit është në përputhje me:

- Shkresën e MIE me Nr. 7572/1 Prot. datë: 24.05.2018, për vazhdimin e procedurave për marrjen e lejes së shfrytëzimit
- "Planin e veprimit për veprimtaritë minerare ndërtimore", sipas Urdhërit të përbashkët Nr. 67, datë: 11.03.2018, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

4. Përshkrimin, sipas rastit, të masave kryesore që duhen marrë për të shmangur, reduktuar e nëse është e mundur, për të korrigjuar efektet negative të rëndësishme:

- 4.1** Ky objekt të ndërtohet në përputhje të plotë me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor, të miratuar nga organet kompetente (KKT / Bashkia / Njësi Administrative) dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- 4.2** Subjekti të mos përdorë në asnjë mënyrë si rrugë kalimi Parkun Kombëtar "Qafë Shtamë".

- 4.3 Në rast se gjatë punimeve shfaqen elemente të tillë si: objekte kulturi, gjurmë arkeologjike, burime ujore etj, subjekti të ndërpresë punimet dhe të lajmërojë urgjentisht organet kompetente.
- 4.4 Kjo deklaratë është e vlefshme pas miratimit nga MIE për Lejen e Shfrytëzimit.
- 4.5 Kjo Deklaratë është e vlefshme pasi subjekti të bëjë heqjen nga Fondi Pyjor, në rast se aktiviteti bie në një të tillë.

Gjatë fazës së instalimit:

- 4.6 Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore
- 4.7 Të instalohet sistemi i eliminimit dhe kapjes së pluhurave, nëpërmjet sprucimit me ujë. (Ky sistem, të detajohet qartë me skica, planimetri etj në aplikimin për Leje Mjedisore)
- 4.8 Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve të subjektit.
- 4.9 Të respektohet distanca nga rruga, gjatë fazës së instalimit dhe kryerjes së punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.
- 4.10 Përdorimi i pajisjeve, automjetet, që emetojnë nivele zhurmash brenda normave të lejuara të emetimit 60 – 100 db.
- 4.11 Subjekti të realizojë në mënyrë të menjëhershme çdo ndërhyrje teknike për të riparuar çdo fenomen negativ në mjedis si pasojë e veprimtarisë së tij.
- 4.12 Të sistemohen brenda sipërfaqes së shfrytëzimit të gjitha sterilet e gjeneruara nga shfrytëzimi i karrierës.
- 4.13 Në raste aksidentesh ose defektesh teknologjike që shkaktojnë ndotje të mjedisit, subjekti menjëherë duhet të jap informacion në DRM-në e qarkut përkatës dhe AKM, të cilat bëjnë të mundur njoftimin e popullatës që preket nga ky aksident.
- 4.14 Të mbillen pemë në të gjithë perimetrin e zonës për të minimizuar ndikimet në mjedis dhe përmirësuar pejsazhin.
- 4.15 Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara gjatë fazës së instalimit, sidomos ato të ambalazhimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit e caktura nga njësia vendore. Zotëruarit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
- 4.16 Përgjatë gjithë rrugës së brendshme të karrierës (përfshi transhetë), të hapet një kanal ujëmbledhës i orientuar drejt një grope dekantimi, për mbledhjen dhe disiplinimin e ujërave gjatë kohës së shfrytëzimit.
- 4.17 Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri i ndërtimit për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.
- 4.18 Subjekti të respektojë kushtet lidhur me mbrojtjen e biodiversitetit, menaxhimin e pyjeve, emetimet në ajër, shkarkimet e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve etj.
- 4.19 Kompania duhet të respektojë gjithashtu kushtet e vendosura në raportin e VNM-së të aplikuar si dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".

